

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këshilli i Sigurimit/ Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël, Begaj të japë llogari njëloj si Rama
ADRESA	https://piranjat.al/politike/keshilli-i-sigurimit-bardhi-shqiptaret-nuk-kane-nevoje-per-spektakel-be-i106002
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:06:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 10:58:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b2f7eb3c9b50f756158745e956d92117fed387ac4933d6967a4ca5b9ec00bb99
TEKSTI	9c2badee260df76f6da425c416069415f323f9ef75e6034308fcc5454d012e07
PAMJA	e26efae34b3468ecb1add3d11cbe527e6ab8ce8f9f2fcbe6be20b0115270a3be

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7e41add82da414d06c8525b151cc316efd5d20f48bc5706957b667a088b00dfc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7e41add82da414d06c8525b151cc316efd5d20f48bc5706957b667a088b00dfc

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

paskepunetori
hedh
kallashnikovin

janë
gjetur 31
bimë të
dushmura

ne
Shqipëri
në kohën

basistuar
të Amerikës
në Tiranë,
Eric Wendt

shqiptaret
paguajnë
qivsmën e

ingritjen e një
strukture të
re për barnat
dhe

shpenzimet
mujore. A
meritojnë

publikë me
të ardhura
më të larta

rritjen më
të dobët

riten me
vetëm
2%
krasuar

POLITIKE

Këshilli i Sigurimit/ Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël, Begaj të japë llogari njëjloj si Rama

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 12:58



Kreu i grupit parlamentar të PD, Gazment Bardhi ka reaguar me një postim në rrjetet sociale pas vendimit të Begajt për të thirrur Këshillin e Sigurisë Kombëtare.

'Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël institucional, por për përgjigje. Bajram Begaj të jap llogari njëjloj si Edi Rama', shkruan Bardhi në postimin e tij.

REAGIM I KRYETARIT TË GRUPIT PARLAMENTAR TË PD, GAZMENT BARDHI

NUK KA NEVOJË PËR SPEKTAKËL INSTITUCIONAL. SHQIPËRIA KA NEVOJË PËR PËRGJIGJE.

Pas zhvillimeve të rënda në Shërbimin Informativ të Shtetit dhe situatës së krijuar pas vendosjes së drejtores së këtij institucioni nën masën e arrestit, Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, pritet të mbledhë Këshillin e Sigurimit Kombëtar javën e ardhshme. Por shqiptarët nuk kanë nevojë për një mbledhje formale dhe as për një shfaqje institucionale. Ata nuk kanë nevojë që të mbledhet Këshilli i Sigurimit të Gysit. Qytetarët kanë nevojë për përgjigje konkrete.

Pyetja e parë dhe më e rëndësishme që i drejtohet Bajram Begajt është e thjeshtë:

MBI ÇFARË VERIFIKIMESH U MBËSHTET VENDIMI PËR DEKRETIMIN E VLORA HYSENIT NË KRYE TË SHISH?

Bajram Begaj duhet t'u shpjegojë shqiptarëve, në mënyrë të plotë dhe transparente, se çfarë informacioni, verifikimesh dhe procedurash janë ndjekur përpara emërimit të saj në krye të një prej institucioneve më të rëndësishme të sigurisë kombëtare. Opozita kishte ngritur publikisht pikëpyetje dhe shqetësime lidhur me këtë emërim. Sot, pas zhvillimeve të fundit, këto pikëpyetje kërkojnë përgjigje të menjëhershme institucionale.

ÇFARË VERIFIKOI PRESIDENTI DHE ÇFARË NUK VERIFIKOI INSTITUCIONI I PRESIDENTIT PËRPARA DEKRETIMIT?

Kjo është një pyetje që nuk mund të anashkalohet. Po aq serioze janë pyetjet që lidhen me sigurinë e informacionit të klasifikuar, burimeve njerëzore dhe informacionit sensitiv që administron SHISH. Nëse ekziston apo ka ekzistuar një rrezik që informacionet e këtij institucioni, identitetet e burimeve apo të informatorëve të jenë ekspozuar ndaj strukturave kriminale ose shërbimeve të vendeve jo mike, atëherë kemi përpara një çështje me pasoja potencialisht shumë të rënda për sigurinë kombëtare.

Por përgjigësia e Presidentit nuk fillon sot.

Gjatë këtyre dy viteve janë ngritur publikisht pretendime dhe shqetësime serioze për mënyrën se si ka funksionuar SHISH dhe për marrëdhënie të pretenduara ndërmjet individëve të caktuar dhe strukturave të krimit të organizuar. Bajram Begaj duhet të sqarojë nëse këto shqetësime janë verifikuar ndonjëherë nga institucionet përrejtëse dhe nëse po, cilat kanë qenë përfundimet e këtyre

verifikimeve.

Nuk i kërkojmë Presidentit të ndërhyjë në hetimet e SPAK-ut apo në vendimmarrjen e gjykatave. I kërkojmë të japë llogari për përgjegjësitë e veta institucionale.

EDHE ÇËSHTJA E BLOKIMIT TË BETIMIT TË ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE PËR LLOGARI TË ERGYS AGASIT KËRKON TRANSPARENCË.

Bajram Begaj duhet të shpjegojë publikisht arsyet dhe bazën institucionale të vonesës së betimit për më shumë se 47 ditë të z. Asim Vokshi dhe të sqarojë nëse kjo vonesë ka qenë pjesë e një procedure normale institucionale apo nëse ka pasur rrethana të tjera që duhet t’u bëhen të ditura qytetarëve. Pretendimet për ndërhyrje të grupeve kriminale apo ndikim të paligjshëm në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese janë tepër serioze për t’u lënë në nivelin e deklaratave politike. Ato kërkojnë transparencë dhe verifikim nga organet kompetente.

Prandaj, Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk mund të përdoret si zëvendësim për llogaridhënien. Presidenti, njëlloj si Kryeministri, duhet të përgjigjet për vendimmarrjen e tij.

Duhet të shpjegojë çfarë verifikoi, çfarë dinte, çfarë nuk dinte dhe çfarë masash janë marrë për mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Shqiptarët nuk kanë nevojë për një President që shfaqet vetëm pasi kriza ka shpërthyer. Shqiptarët kanë nevojë për një President që merr përgjegjësi, jep llogari dhe garanton se institucionet e sigurisë së Republikës nuk përdoren për interesa politike apo kriminale. Prandaj, përpara çdo mbledhjeje formale të Këshillit të Sigurimit Kombëtar, Bajram Begaj duhet t’u japë shqiptarëve transparencën që meritojnë.

Jo propagandë. Jo formalitet. Jo heshtje. Përgjegjësi dhe transparencë.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 25 Shtator12:17

[Deputetja e PS-së, Iris Luarasi del në mbrojtje të Klodiana Lalës dhe godet Vlorë Hysenin: E papranueshme](#)

Deputetja socialiste Iris Luarasi del publikisht në krah të gazetares Klodiana Lala dhe kritikon deklaratat e Vlorë Hysenit në hyrje të GJKK...

POLITIKE 25 Shtator12:21

[Gazeta amerikane: Gjenerali Wendt zbarkon në Shqipëri në kohën kur vendi është përfshirë nga protestat](#)

Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Eric Wendt, pritet të mbërrijë së shpejti në ...

POLITIKE 25 Shtator12:11

[PD ankimon në Kushtetuese VKM-në e Ramës që i hapi rrugë ndërtimeve të projekteve 'Albanian Files' në Pishporo Nartë](#)

PD ka ankimuar në Gjykatën Kushtetuese VKM e kryeministrit Rama e cila i hap rrugën planeve ndërtimore të qeverisë me proje...

POLITIKE 25 Shtator12:05

[Tabaku: Rama po përgatit ‘KAYO-n’ e shëndetësisë, shqiptarët paguajnë gjysmën e faturës nga xhepi](#)

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, kundërshton ngritjen e një strukture të re për barnat dhe shërbimet spitalore, d...

Nga Xhuljan Ferzaj POLITIKE 25 Shtator11:18

[Pagat e “majme” të deputetëve, 3500-7000 euro shpenzimet mujore. A meritojnë të paguhen kaq shumë?](#)

Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë mbeten ndër funksionarët publikë me të ardhura më të larta në vend. Piran...

POLITIKE 25 Shtator10:31

[“TIMAK Defence” dhe KAYO në qendër të denoncimit të PD: Thesari pagoi 8.6 milionë lekë! Si u lëshua fatura para procedurës?](#)

Partia Demokratike ka ngritur pikëpyetje lidhur me një pagesë prej 8.6 milionë lekësh ndaj kompanisë “TIMAK Defence”...

POLITIKE 24 Shtator23:03

[Nga shkarkimi në Kosovë te kreu i SHISH/ Berisha: Rama dhe Vlorë Hyseni, nën urdhrat e Vuçiç! Haxhiu... kumbari](#)

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka reaguar ashpër pas arrestimit të ish-drejtoreshës së SHISH, Vlorë Hyseni, duke rikthyer n&...

POLITIKE 24 Shtator22:58

[Ish-deputeti: Dumani pinte kafe çdo të hënë me Vlorën, në qershor të 2025 e përzuri nga zyra](#)

Ish-deputeti Myslim Murrizi ka bërë një deklaratë të fortë lidhur me ish-drejtoreshën e SHISH, Vlorë Hyseni. Në Top Sto...

POLITIKE 24 Shtator22:51

[Gazeta franceze: Tjetër skandal në qeverinë e Ramës, BE po e vëzhgon](#)

Nga L'Express Nga shërbimi sekret, në arrest shtëpiak. Kreu i shërbimit të inteligjencës së Shqipërisë (SHIS...

POLITIKE 24 Shtator22:35

[Gazetari Arion Sulo: Faktori ndërkombëtar e ka dhënë lejen për shkarkimin dhe hetimin e Vlorë Hysenit](#)

Gazetari Arion Sulo ka folur në “Top Story” për hetimin dhe masën e sigurisë “arrest shtëpie” për ish-drej...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...](#)

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...](#)

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në nj&eum...

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...](#)

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...


video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.